



GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË
.....
Nr. 30 / 31 DHJETOR 2011

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës e publikon : Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në mbështetje të Ligjit për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-190.

Në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës publikohen: Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të shpallura nga Presidenti i Republikës së Kosovës; Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me paragrafin 4 dhe 5 të nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Vendimet e Gjykatës Kushtetuese; Dekretet e Presidentit të Republikës së Kosovës në rastet kur kërkohet nga Presidenti; Deklaratat dhe rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në rastet kur kërkohet nga Kryetari i Kuvendit; Aktet nënligjore të Qeverisë dhe të ministrive në rastet kur kërkohet nga Kryeministri dhe Aktet tjera të përcaktuara me ligje të veçanta, si dhe INDEKS-i vjetor i Gazetës Zyrtare.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në pesë gjuhë: në gjuhën Shqipe, Angleze, Serbe, Turke dhe atë Boshnjake.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës administrohet nga Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Mbikëqyrja editoriale:

Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës:
Fitim Krasniqi

Drejtori i Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës:
Naser Canolli

Redaktori Përgjegjës i Gazetës Zyrtare:
Fehmi Stublla

Redaksia e Gazetës Zyrtare:

Hysen Bajramaj
Shqipe Fazliu-Gashi
Nergjivan Gjota
Besart Graiçevci

Adresa dhe Korrespondenca:

Ndërtesa e Re e Qeverisë,
Prishtinë
038-200-14039 / 038-200-14811

Ueb-faqja e Gazetës Zyrtare:

<http://gazetazyrtare.rks-gov.net>

E-mail adresa: Info-gzk@ks-gov.net

NË RAST MOSPËRPTHJE NDËRMJET VERSIONEVE GJUHËSORE TË AKTEVE JURIDIKE TË BOTUARA DHE TË PUBLIKUARA NË GAZETËN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËRPARËSI DO TË KENË GJUHËT ZYRTARE NË PËRPTHJE ME KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

PËRMBAJTJA

LIGJI PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E DËSHMORËVE, INVALIDËVE, VETERANËVE, PJSËTARËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, VIKTIMAVE CIVILE DHE FAMILJEVE TË TYRE.....1

SHTOJCA E LIGJIT Nr. 04/L-054 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E DËSHMORËVE, INVALIDËVE, VETERANËVE, PJSËTARËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, VIKTIMAVE CIVILE DHE FAMILJEVE TË TYRE.....2

LIGJI PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2012.....16

LIGJI Nr. 04/L-054
PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E DËSHMORËVE, INVALIDËVE, VETERANËVE, PJSËTARËVE TË
USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, VIKTIMAVE CIVILE DHE FAMILJEVE TË TYRE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

LIGJ PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E DËSHMORËVE, INVALIDËVE, VETERANËVE, PJSËTARËVE
TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, VIKTIMAVE CIVILE DHE FAMILJEVE TË TYRE

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i nxjerrjes i këtij ligji është përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendit.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Me këtë ligj rregullohet dhe përcaktohet:

1.1. statusi i dëshmorëve, të zhdukurve të UÇK-së, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre;

1.2. të drejtat dhe beneficionet e posaçme për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, familjeve të veteranëve dhe invalidëve të vdekur, pjesëtarëve të UÇK-së të marrë peng ose të zhdukur dhe anëtarëve të ngushtë të familjeve të tyre, si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave;

1.3. statusi dhe të drejtat e viktimave civile, invalidëve civil të luftës dhe familjeve të të marrurëve peng dhe të zhdukurve civil të luftës.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **UÇK** - Ushtria Çlirimtare e Kosovës;

1.2. **SHP** - Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së;

1.3. **SHFD** - Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së;

1.4. **OVL** - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së;

1.5. **SHIL** - Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së;

1.6. **Dëshmor i Kombit** - pjesëmarrësi i UÇK-së që:

1.6.1. ka rënë në luftë për lirinë e vendit nga viti 1997 -1999;

1.6.2. është plagosur në luftë për lirinë e vendit në periudhën 1997 -1999 dhe ka vdekur nga plagët e marra brenda tri (3) viteve.

1.7. **Invalid i luftës së UÇK-së** - pjesëmarrësi i UÇK, organizmi i të cilit është dëmtuar mbi 20% për shkak të plagës, lëndimit apo sëmundjes që ka pësuar në luftë, apo si i internuar (i burgosur) në burgjet apo kampet e

armikut dhe shtetasi i huaj si veteran i UÇK-së, nga 1997- 1999;

1.8. **Invalid civil i luftës** - personi, organizmi i të cilit është dëmtuar së paku 40 % si pasojë e plagëve të marra nga armët, sëmundjes së fituar në burgjet apo kampet gjatë luftës së fundit në Kosovë, prej datës 27.02.1998 deri me datën 20.06.1999, si dhe personat e tjerë, organizmi i të cilëve është dëmtuar së paku 40 % si pasojë e mjeteve shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës;

1.9. **Veteran i UÇK-së** – qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar si ushtar nga komandat (shtabet e zonave operative të UÇK-së), përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, gjatë periudhës 1997-1999;

1.10. **Viktimë Civile e Luftës** - personi i cili është vrarë apo është plagosur, nga forcat e armikut, e më vonë ka vdekur brenda periudhës 27.02.1998 deri me 20.06.1999, si dhe personat që kanë pësuar si pasojë e luftës brenda tri (3) viteve që nga përfundimi i luftës nga mjetet shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës;

1.11. **Peng i luftës** - veterani dhe pjesëtari i UÇK-së i cili gjatë luftës çlirimtare të Kosovës është arrestuar dhe internuar në kampe së paku tre (3) ditë **përkatësisht shtatëdhjetedy (72) orë**;

1.12. **Peng civil i luftës** - personi civil, i cili gjatë luftës është arrestuar dhe internuar në kampet e armikut së paku tre (3) ditë **përkatësisht shtatëdhjetedy (72) orë**;

1.13. **Ushtar i zhdukur (i pagjetur) i UÇK-së** - veterani dhe pjesëtari i UÇK-së, fati i të cilit ende nuk është zbardhur;

1.14. **Person civil i zhdukur** - personin vendndodhja e të cilit është e panjohur për familjarët e tij/saj dhe i cili në bazë të informacionit të besueshëm, është zhdukur në periudhën mes 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999;

1.15. **Anëtarë të familjes së ngushtë** në kuptim të këtij ligji janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), prindërit, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtira si dhe bashkëshorti/ bashkëshortja jashtëmartesore:

1.15.1. statusi i bashkësisë jashtëmartesore sipas këtij ligji përcaktohet me procedurë gjyqësore jashtë kontestimore.

1.16. **Familje e Dëshmorit të Kombit** - ajo familje e cila i ka dhënë Kosovës, një apo më shumë dëshmorë;

1.17. **ZKM** - Zyra e Kryeministrit;

1.18. **ZÇKL** - Zyra për çështjet e kategorive të dala nga lufta;

1.19. **Ministria** - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

1.20. **TMK** - Trupat Mbrojtëse të Kosovës.

1.21. **Ish Ministria e Mbrojtjes** - Ministria e Mbrojtjes së Ish Qeverisë së Kosovës në ekzil.

Neni 4

Realizimi i të drejtës në pension dhe beneficione

Varësisht nga njohja dhe rregullimi i statusit, kategorive të trajtuara në këtë ligj, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme do t'ju sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së.

Neni 5

Llojet e pensioneve

1. Në përputhje me njohjen dhe përcaktimin e statusit për kategoritë e dala nga lufta, pensionet e përcaktuara në këtë ligj janë:

1.1. **Pensioni familjar** të cilin e realizojnë:

1.1.1. familja e ngushtë e dëshmorit;

1.1.2. familja e ngushtë e të zhdukurit të UÇK-së;

1.1.3. familja e ngushtë e viktimës civile të luftës;

1.1.4. familja e ngushtë e të zhdukurit civil;

1.1.5. pensionin familjar, familja e ngushtë e realizon për të rënë dhe të zhdukurit në vitet 1997-1999.

1.2. **Pensioni invalidor personal** të cilin e realizojnë:

1.2.1. invalidi i UÇK-së; dhe

1.2.2. invalidi civil i luftës, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj;

1.3. **Pensioni invalidor familjar** të cilin e realizon familja e ngushtë pas vdekjes së invalidit, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj;

1.4. Përfituesit e pensioneve sipas paragrafit 1.1., 1.2 dhe 1.3. të këtij neni, nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë, përveç nëse ndryshe është përcaktuar me ligj.

Neni 6 Benificionet e veçanta

1. Kategoritë e trajtuara në këtë ligj, varësisht nga statusi dhe kriteret e përcaktuara, për shkak të sakrificës sublimë dhe kontributit shumë të lartë në luftën çlirimtare të UÇK-së, janë përfitues edhe të beneficioneve të veçanta, të cilat janë:

1.1. shtesa për përkujdesje dhe ndihmë nga personi tjetër është e drejtë të cilën e realizon invalidi i UÇK-së dhe invalidi civil i luftës me shkallë të invaliditetit mbi 80%;

1.2. rehabilitimi mjekësor dhe fizikal është e drejtë që e realizojnë të gjithë invalidët e UÇK-së, me prioritet sipas shkallës së invaliditetit;

1.3. shërbimet shëndetësore primare, sekondare dhe terciare janë të drejta të cilat i realizojnë pa kompensim në institucionet shëndetësore publike, familjet e dëshmorëve, të të zhdukurve të UÇK-së, invalidëve të UÇK-së, si dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre;

1.4. shërbimet shëndetësore spitalore jashtë vendit, janë të drejta të cilat i realizojnë pa kompensim, të gjithë invalidët e UÇK-së, në qoftë se është në pyetje sëmundja, e cila nuk mund të shërohet në vendin tonë;

1.5. shërbimet shëndetësore jashtë vendit i gëzojnë edhe invalidët civil të luftës për gjendjen shëndetësore të përkeqësuar, që është pasojë e luftës dhe për të cilën nuk ka shërim në vendin tonë;

1.6. riaftësimi profesional është e drejtë të cilën e realizon invalidi i UÇK-së, invalidi civil i luftës, të cilët janë pjesërisht të aftë për punë, duke përfshirë edhe aftësimin për kryerjen e punëve për të cilat kërkohet përgatitje profesionale më e lartë se ajo të cilën e ka pasur, pa marrë parasysh se a i sigurohet punësimi pas riaftësimit profesional;

1.7. kompensimi ortopedik është e drejtë e sigurimit të mjeteve ortopedike për invalidët e UÇK-së dhe invalidët civil të luftës, të cilëve u është dëmtuar organizmi nga plagosja, apo amputimi i ekstremiteteve;

1.8. përparësi në punësim në ndërmarrjet e sektorit publik dhe privat, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-19 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, është e drejtë të cilën e realizojnë invalidët e UÇK-së.

2. Lirimi nga tatimi dhe dogana për veturat speciale për përdorim personal (një veturë në çdo pesë (5) vjet) si dhe i pajisjes ortopedike janë të drejta të cilat i realizojnë invalidët e UÇK nga grupet I deri në grupin VII në përshtatshmëri

me shkallën e paaftësisë të përcaktuar me nenin 10 të këtij ligji.

3. Tarifa e liruar dhe reduktimi i harxhimeve të energjisë elektrike për nevoja personale, është e drejtë të cilën e gëzojnë familjet e ngushta të dëshmorëve dhe invalidët e UÇK në rast të gjendjes së rëndë ekonomike, kur i plotëson kriteret sipas skemës së asistencës sociale.

4. Lirimi nga tatimi në pronë është e drejtë që e realizojnë familjet e dëshmorëve, familjet e të zhdukurve të UÇK-së, invalidët e UÇK-së, invalidët civil të luftës, familjet e viktimave civile të luftës që janë në gjendje të rëndë ekonomike.

5. Stazhi i dyfishtë është e drejtë të cilën e realizojnë invalidët si të papunësuar apo të punësuar për kohën e kaluar në luftë.

6. Përkujdesja për banim është e drejtë të cilën e realizojnë familjet e dëshmorëve, të të zhdukurve të UÇK-së, invalidëve të UÇK-së të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike, invalidët civil të luftës dhe familjet e ngushta të viktimave civile të luftës, për të cilët Qeveria e Kosovës do të angazhohet për sigurimin e strehimit familjar përmes ndërtimit të objekteve kolektive të banimit social:

6.1. përparësi për realizimin e të drejtës në strehim familjar do ta kenë familjet e ngushta të dëshmorëve dhe të zhdukurve, invalidëve të cilët nuk e kanë të zgjidhur strehimin familjar.

7. Përparësia e regjistrimit dhe pranimit në institucionet arsimore publike është e drejtë të cilën e realizojnë personat që janë anëtarë të familjeve të dëshmorëve, të zhdukurve të UÇK-së, invalidëve të UÇK-së dhe familjet e tyre.

8. Lirimi nga pagesat administrative në shkollimin Universitar Publik, është e drejtë të cilët e realizojnë, personat që janë anëtarë të familjeve të dëshmorëve, të zhdukurve të UÇK-së, invalidëve të UÇK-së dhe familjet e tyre.

9. Shpenzimet e varrimit, të transportit dhe nderimet ushtarake, janë ato shpenzime dhe akte ceremoniale mortore, të cilat i kompenson Ministria pas procedurave të ekskumacionit dhe identifikimit të ushtarit të zhdukur të UÇK-së.

Neni 7

Përparësitë në realizimin e të drejtave dhe beneficioneve

1. Përparësitë në realizimin e të drejtave, në mes anëtarëve të familjes së ngushtë sipas këtij ligji, përfituesit i realizojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Trashëgiminë. Anëtarët e familjes të radhës së njëjtë të trashëgimisë, do t'i realizojnë të drejtat sipas marrëveshjes së ndërsjellët.

2. Në qoftë se marrëveshja nuk arrihet, përparësi në realizimin e të drejtës ka anëtari i familjes së ngushtë nga radha e njëjtë e trashëgimisë, i cili me personin nga i cili realizohet e drejta, ka jetuar në bashkësi të njëjtë familjare.

Neni 8

E drejta në pension dhe beneficione për familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së

1. Anëtarët e ngushtë të familjes së dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë Ligj, realizojnë këto të drejta dhe beneficione:

1.1. të drejtën në pensionin familjar;

1.2. përparësinë në punësim në kushte të barabarta;

1.3. përparësinë në regjistrim dhe pranim në institucione arsimore publike në kushte të barabarta me të tjerët;

1.4. bursën për shkollim të mesëm dhe universitar;

1.5. vendosjen në konvikte pa kompensim;

1.6. përkujdesjen për strehim familjar;

1.7. tarifë të lirë dhe të reduktuar të konsumit të energjisë elektrike për nevoja personale në rast të gjendjes së rëndë ekonomike, kur i plotëson kriteret sipas skemës së asistencës sociale;

1.8. lirimin nga pagesa e taksave gjyqësore, administrative dhe publike;

- 1.9. përkujdesjen shëndetësore primare, sekondare dhe terciare falas, në institucione publike shëndetësore;
 - 1.10. vendosjen pa kompensim në shtëpitë e personave të moshuar;
 - 1.11. lirim nga pagesat administrative në shkollimin universitar publik;
 - 1.12. lirim nga pagesa në trafikun publik urban dhe ndër urban.
2. Këto të drejta i realizojnë edhe të gjitha familjet e dëshmorëve të kombit, të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit në periudha të ndryshme historike.
3. Bashkëshorti/ja që lidhë martesë të re i humb të drejtat e përcaktuara me këtë ligj, të cilat i ka shfrytëzuar si anëtar i familjes së ngushtë të dëshmorit apo të të zhdukurit.
4. Kur fëmijët e dëshmorit apo të zhdukurit të UÇK-së, pa përkujdesje prindërore janë përfitues të pensionit familjar, këtë të drejtë e realizojnë deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, përkatësisht deri në moshën njëzetegjashtë (26) vjeçare nëse janë në shkollim të rregullt.
5. Baza e pensioneve familjare për familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së caktohet sipas Shtojcës 1 të këtij ligji dhe të parashikuara me Ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2011.

Neni 9 **Të drejtat dhe beneficionet e invalidëve të UÇK-së**

1. Invalidët e UÇK-së, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj, realizojnë këto të drejta dhe beneficione:
- 1.1. të drejtën në pensionin invalidor personal;
 - 1.2. të drejtën në pensionin invalidor familjar pas vdekjes së invalidit;
 - 1.3. shtesa për përkujdesje dhe ndihmë personit tjetër për invalidët e UÇK-së me shkallë invaliditeti prej 81 % deri 100%;
 - 1.4. kompensimin ortopedik për sigurimin e mjeteve ortopedike;
 - 1.5. përkujdesjen shëndetësore primare, sekondare dhe terciare pa kompensim në institucionet shëndetësore publike;
 - 1.6. rehabilitimin shëndetësor dhe fizikal;
 - 1.7. riaftësimin profesional për invalidët, të cilët kanë aftësi të pjesërishtme të punës;
 - 1.8. përparësi në punësim në kushte të barabarta të punës;
 - 1.9. përparësinë për regjistrim dhe pranim në institucione arsimore publike në kushte të barabarta me të tjerët;
 - 1.10. bursën për shkollim të mesëm dhe universitar;
 - 1.11. vendosjen në konvikte pa kompensim;
 - 1.12. përkujdesje në strehim familjar;
 - 1.13. lirim nga taksa gjyqësore, administrative dhe publike;
 - 1.14. tarifë të lirë dhe të reduktuar të konsumit të energjisë elektrike për nevoja personale në rast të gjendjes së rëndë ekonomike, kur i plotëson kriteret sipas skemës së asistencës sociale;
 - 1.15. vendosjen në shtëpitë e personave të moshuar pa kompensim;

1.16. shpenzimet e varrimit së bashku me nderimet ushtarake.

2. Të drejtat dhe beneficionet e përcaktuara në paragrafin 1. nën-paragrafët 1.2., 1.5., 1.9., 1.10., 1.11. dhe 1.12. të këtij neni i realizojnë edhe anëtarët e familjes së ngushtë të invalidëve të UÇK-së.

Neni 10 **Të drejtat e invalidëve të UÇK-së sipas shkallës së invaliditetit**

1. Me qëllim të realizimit të të drejtave dhe beneficioneve, në përputhje me shkallën e invaliditetit dhe përqindjen e përcaktuar të dëmtimit trupor, invalidët e UÇK-së ndahen në tetë (8) grupe:

- 1.1. Grupi I - invalidët me 81% deri 100% të dëmtimit trupor;
- 1.2. Grupi II - invalidët me 71% deri 80% të dëmtimit trupor;
- 1.3. Grupi III - invalidët me 61% deri 70% të dëmtimit trupor;
- 1.4. Grupi IV - invalidët me 51% deri 60% të dëmtimit trupor;
- 1.5. Grupi V - invalidët me 41% deri 50% të dëmtimit trupor;
- 1.6. Grupi VI - invalidët me 31% deri 40% të dëmtimit trupor;
- 1.7. Grupi VII - invalidët me 20 % deri 30 % të dëmtimit trupor;
- 1.8. Grupi VIII - invalidët me 10% deri 19% të dëmtimit trupor.

2. Vlerësimin mjekësor për shkallën e invaliditetit sipas paragrafit 1. të këtij neni, e bëjnë komisionet mjekësore të Ministrisë, fillimisht në Shkallë të parë me mundësi të ankimit edhe në Shkallën e dytë.

3. Baza e pensionit invalidor personal caktohet sipas Shtojcës 1 të këtij ligji dhe të parashikuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit të vitit 2011.

4. Invalidi i UÇK-së me shkallë invaliditeti 10 deri 19% nuk e gëzon pensionin invalidor personal.

5. Invalidi i UÇK-së me shkallë të invaliditetit mbi 80% ka të drejtë në shtesë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër, në lartësinë e përcaktuar me Shtojcën 1 të këtij ligji dhe të parashikuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit të vitit 2011.

6. Nëse brenda një familje të ngushtë një nga anëtarët është shfrytëzues i pensionit invalidor personal, anëtarëve tjerë të familjes nuk i'u përjashtohet mundësia e shfrytëzimit të së drejtës në pensionin familjar pas vdekjes së invalidit.

7. Përfutuesi, të cilit i është njohur e drejta e pensionit invalidor, nuk e përjashton të drejtën e anëtarëve të ngushtë të familjes për aplikim në ndihmë sociale, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.

Neni 11 **E drejta në pensionin invalidor familjar pas vdekjes së invalidit të UÇK-së**

1. Pas vdekjes së invalidit të UÇK-së, të drejtën në pension invalidor familjar, e realizojnë anëtarët e familjes së tij të ngushtë.

2. Baza e pensionit invalidor familjar pas vdekjes së invalidit të UÇK-së caktohet sipas Shtojcës 1 të këtij ligji dhe të parashikuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit të vitit 2011.

3. Bashkëshorti/ja që lidh martesë të re, pas vdekjes së invalidit të UÇK-së, i humb të drejtat në pension dhe beneficione, të përcaktuara me këtë ligj.

4. Kur fëmijët e invalidit të UÇK-së pa përkujdesje prindërore janë përfutues të pensionit familjar, këtë të drejtë e realizojnë deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, përkatësisht deri në moshën njëzetegjashmë (26) vjeçare nëse janë në shkollim të rregullt.

5. Invalidët e UÇK-së të plagosur gjatë periudhës së luftës, të cilët kanë vdekur brenda tri (3) viteve pas përfundimit të luftës, si pasojë e plagëve të marra në luftë, të cilët nuk kanë qenë të vlerësuar nga komisioni mjekësor i Ministrisë për caktimin e shkallës së invaliditetit, familjet e tyre do të kenë të drejtën në pension familjar në lartësi prej 100% nga baza e pensionit e përcaktuar sipas këtij ligji.

Neni 12

Statusi dhe të drejtat e veteranëve të UÇK-së

1. Sipas dispozitave të këtij ligji, nga organi përgjegjës i Qeverisë, njihet dhe përcaktohet statusi i veteranëve të UÇK-së.

2. Të drejtat në beneficione për veteranët e UÇK-së si dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre do të rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 13

Të drejtat e anëtarëve të familjes së viktimës civile të luftës

1. Anëtarët e familjes së ngushtë të viktimës civile të luftës, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj, i realizojnë këto të drejta dhe beneficione:

1.1.pensionin familjar;

1.2.përkujdesjen shëndetësore primare dhe sekondare pa kompensim në institucionet shëndetësore publike;

1.3.lirimin nga tatimi në pronë, nëse familja e ngushtë është në gjendje të rëndë materiale;

1.4.tarifë të lirë dhe të reduktuar të konsumit të energjisë elektrike për nevoja personale nëse familja e ngushtë përballet me gjendje të rëndë ekonomike dhe i plotëson kriteret sipas skemës së asistencës sociale.

2. Shfrytëzues të pensionit sipas radhës janë: bashkëshorti/ja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), prindërit, thjeshtri, thjeshtra.

3. Bashkëshorti/ja që lidhë martesë të re i humb të drejtat e parapara me këtë ligj, të cilat i ka shfrytëzuar si anëtar i familjes së ngushtë i viktimës civile të luftës.

4. Kur fëmijët e viktimës civile të luftës pa përkujdesje prindërore janë përfitues të pensionit familjar këtë të drejtë e realizojnë deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare përkatësisht deri në moshën njëzetegjashtë (26) vjeçare, nëse janë në shkollim të rregullt.

5. Baza e pensioneve familjare për viktimat civile të luftës caktohet sipas Shtojcës 1 të këtij Ligji dhe të parashikuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit të vitit 2011.

6. Baza e pensionit civil familjar për familjen e ngushtë e cila ka dy (2) viktimat civile, rritet për 20%.

7. Baza e pensionit civil familjar për familjen e ngushtë e cila ka tri (3) viktimat civile, rritet për 30%.

8. Baza e pensionit civil familjar për familjen e ngushtë e cila ka katër (4) viktimat civile, rritet për 40%.

9. Baza e pensionit civil familjar për familjen e ngushtë e cila ka më shumë se katër (4) viktimat civile, rritet për 50 %.

10. Anëtarët e familjes së ngushtë të marrë peng apo të zhdukur në periudhën e luftës, i realizojnë të gjitha të drejta dhe beneficionet, sikurse anëtarët e familjes së ngushtë të viktimës civile të luftës të përcaktuara sipas këtij ligji.

Neni 14

Të drejtat dhe beneficionet e invalidëve civil të luftës

1. Të drejtën në pensionin invalidor civil të luftës e realizojnë invalidët civil të luftës me shkallë të invaliditetit prej 40%-100%.

2. Me qëllim të realizimit të të drejtave të përcaktuara me këtë ligj, sipas shkallës së invaliditetit, invalidët civil të luftës radhiten në pesë (5) grupe:

- 2.1. Grupi I - invalidët civil të luftës me 81-100% të shkallës së invaliditetit, të cilëve për jetë të rregullt iu nevojitet përkujdesja dhe ndihma e personit tjetër;
- 2.2. Grupi II - invalidët civil të luftës me 71%-80% të shkallës së invaliditetit;
- 2.3. Grupi III - invalidët civil të luftës me 61%-70% të shkallës së invaliditetit;
- 2.4. Grupi IV - invalidët civil të luftës me 51%-60% të shkallës së invaliditetit;
- 2.5. Grupi V - invalidët civil të luftës me 40%-50% të shkallës së invaliditetit.

3. Vlerësimin për shkallën e invaliditetit të invalidëve civil të luftës sipas paragrafit 2. të këtij neni e bën Komisioni Mjekësor i Shkallës së parë dhe të dytë i cili vepron dhe punon në kuadër të Ministrisë.

4. Baza e pensionit invalidor civil caktohet sipas Shtojcës 1 të këtij ligji dhe të parashikuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit të vitit 2011.

5. Invalidi civil i luftës me dëmtim trupor mbi 80%, lirohet nga tatimi dhe doganat për importimin e mjeteve ortopedike për nevojat e tij personale.

6. Invalidi civil i luftës me shkallë invaliditeti mbi 80% ka të drejtë në shtesë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër, ku caktohet sipas Shtojcës 1 të këtij ligji dhe të parashikuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit të vitit 2011.

Neni 15 Njohja dhe rregullimi i statusit

1. Statusi i dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së, veteranit, pjesëtarit të UÇK-së dhe të internuarit të UÇK-së, konstatohet nga Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së, veteranit, pjesëtarit të UÇK-së apo të internuarit të UÇK-së.

2. Statusi i viktimës civile dhe invalidit civil të luftës, konstatohet nga organi përgjegjës i Komunës përkatëse, sipas kushteve dhe kriteve të përcaktuara me aktin nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

3. Për sakrificën dhe kontributin e jashtëzakonshëm në luftën e UÇK-së, për lirinë dhe çlirimin e vendit, Adem Jasharit i njihet statusi: Komandant Legjendar i UÇK-së.

4. Krahas Komandantit Legjendar Adem Jashari, për sakrificën dhe kontributin për lirinë dhe çlirimin e Kosovës, Familjes Jashari nga Prekazi (Komuna e Skënderajit) i njihet statusi i veçantë, ku përveç të drejtave dhe beneficioneve të përcaktuara me këtë ligj i njihen edhe të drejta dhe beneficione tjera të cilat përcaktohen me akt nënligjor të veçantë të nxjerrë nga Qeveria.

5. Epopeja e UÇK-së përkujtohet me datën 5, 6 dhe 7 mars.

6. Akti nënligjor nga paragrafi 3. dhe 5. i këtij neni nxirret nga Qeveria, në afatin kohor më së largu prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

7. Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së, apo të internuarit të UÇK-së, themelohet me Vendim të Qeverisë dhe në përbërje të tij do të ketë së paku përfaqësues të:

- 7.1. Zyrës së Kryeministrit;
- 7.2. Ministrisë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale;
- 7.3. Ministrisë përkatëse për Forca të Sigurisë;
- 7.4. Ish Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së;
- 7.5. Ish Zonave operative të UÇK-së;

- 7.6. Organizatës së Veteranëve të UÇK-së;
- 7.7. Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së;
- 7.8. Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së;
- 7.9. Ish TMK-së;
- 7.10. Ish Ministrisë së Mbrojtjes;
- 7.11. Përfaqësues tjerë për të cilët vendos Qeveria.

8. Organizimi i punës, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë, pagesa për angazhimet e anëtarëve si dhe çështjet tjera të rëndësishme të Komisionit Qeveritar do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës.

9. Komisioni Qeveritar i përcaktuar në paragrafin 7. të këtij neni, duke u bazuar në dokumentacionin e Ministrisë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Ish Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, Ish TMK-së, dhe sipas nevojave dhe kërkesave dokumentacionit tjetër përkatës që e lëshon organi kompetent i komunës, përcakton Listën e personave të kategorive të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 16

Parashtrimi i kërkesës për realizimin e të drejtave

1. Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj përmes kërkesës në formë të shkruar, i realizojnë qytetarët e Kosovës dhe shtetasit e huaj të cilët e kanë fituar statusin e kategorive përkatëse të përcaktuara me këtë ligj.
2. Për realizimin e së drejtës në pension, sipas dispozitave të këtij ligji, aplikuesi e paraqet kërkesën në Zyrën Rajonale të Departamentit të Ministrisë për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe viktimat civile të luftës.
3. Për realizimin e së drejtave në beneficione tjera, sipas dispozitave të këtij ligji, aplikuesi e paraqet kërkesën në Ministrinë dhe institucionet tjera përkatëse.
4. Afati përfundimtar për të parashtruar kërkesën, për realizimin e të drejtave në pensione dhe beneficione të përcaktuara, sipas këtij ligji është një (1) vit, nga fillimi dhe zyrtarizimi i punës së Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të kategorive të luftës së UÇK-së.
5. Të gjithë ata të cilët aplikojnë pas afatit kohor të paraparë në paragrafin 4. të këtij neni, nuk do të mund të jenë përfitues të pensioneve dhe beneficioneve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 17

Zyra për Çështjet e Kategorive të dala nga Lufta

1. Zyra për çështjet e kategorive të dala nga lufta e cila vepron në kuadër të ZKM-së, apo në subjektin pasardhës që vendos Qeveria, është organ qeveritar e cila bashkërendon dhe koordinon aktivitetet për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së të përcaktuara në këtë ligj.
2. Zyra për Çështjet e Kategorive të dala nga lufta:
 - 2.1. mban Regjistrin Qendror për dëshmorët e kombit, invalidët e UÇK-së, veteranët, pjesëtarit të UÇK-së dhe për të internuarit e UÇK-së, viktimat civile dhe invalidët civil të luftës, sipas Listës së personave të kategorive të përcaktuara me këtë ligj nga Komisioni Qeveritar i përcaktuar në nenin 15 të këtij ligji;
 - 2.2. të dhënat e Regjistrit Qendror, të përcaktuar në paragrafin e mësipërm, trajtohen në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
 - 2.3. lëshon Vërtetime duke u bazuar në Regjistrin Qendror për të gjitha kategoritë;
 - 2.4. i siguron Komisionit Qeveritar të themeluar sipas nenit 15 të këtij ligji mbështetjen administrative dhe

financiare;

2.5. kompetencat tjera dhe organizimi i Zyrës për Çështjet e Kategorive të dala nga Lufta përcaktohen me Rregullore të aprovuar nga Qeveria.

Neni 18

Afatet kohore për realizimin e të drejtave në pensione

Të drejtat në pensione të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji si dhe shtesat për përkujdesje dhe ndihmë personit tjetër, realizohen nga dita e paraqitjes së kërkesës, nëse janë plotësuar kushtet dhe kriteret për realizimin e këtyre të drejtave.

Neni 19

Zbatimi i ligjit për procedurën e përgjithshme administrative

Nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe, drejtpërsëdrejti do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 20

Aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit

1. Për zbatimin e këtij ligji në afat prej gjashtë (6) muajsh, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria e Kosovës dhe ministritë përkatëse nxjerrin këto akte nënligjore:

1.1. Qeveria:

1.1.1. rregulloren për përcaktimin e kushteve, kriterëve dhe procedurave për njohjen e statusit të dëshmorit të kombit;

1.1.2. kompetencat e tjera dhe organizimi i Zyrës për Çështje të Veteranëve të Luftës së UÇK-së, përcaktohen me Rregullore të aprovuar nga Qeveria;

1.1.3. rregulloren për fushëveprimin dhe funksionimin e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe përcaktimin e statusit të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së;

1.1.4. rregulloren për përcaktimin e kushteve, kriterëve dhe përmbajtjen e kartelës identifikuese, të sigurisë së lartë, që mundëson identifikimin e qartë të përfituesve të beneficioneve për kategoritë e trajtuara në këtë ligj.

1.2. Ministria përgjegjëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale:

1.2.1. Udhëzimin Administrativ për procedurat e aplikimit për realizimin e të drejtave të përcaktuara me këtë ligj;

1.2.2. udhëzimin Administrativ për vlerësimet dhe ekzaminimet e shkallës së invalidit të luftës së UÇK dhe invalidit civil;

1.2.3. udhëzimin Administrativ për kompensimin e shpenzimeve të varrimit dhe bërjen e nderimeve ushtarake me rastin e vdekjes së veteranit, pjesëtarit dhe invalidit të UÇK-së.

1.3. Ministria përgjegjëse për çështje të Shëndetësisë:

1.3.1. udhëzimin Administrativ për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për shfrytëzimin e të drejtës për rehabilitim shëndetësor dhe fizikal për kategoritë e trajtuara në ligj;

1.3.2 udhëzimin Administrativ për realizimin e së drejtës në shërbimet shëndetësore në institucionet shëndetësore publike;

1.3.3. udhëzimin Administrativ për realizimin e të drejtës në mjetet ndihmëse ortopedike për nevojat e invalidëve të luftës dhe invalidëve civil.

1.4. Ministria përgjegjëse për Arsim, Shkencë dhe Teknologji:

1.4.1. Udhëzimin Administrativ për njohjen e të drejtës dhe përcaktimin e procedurave për ndarjen e teksteve shkollore falas;

1.4.2. Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për realizimin e së drejtës në bursë;

1.4.3. Udhëzimin Administrativ për caktimin e kushteve dhe kritereve për vendosjen në konvikte, të anëtarëve të ngushtë të familjeve të kategorive të trajtuar në këtë ligj.

1.5. Ministria përgjegjëse për çështjet e energjisë:

1.5.1. udhëzimin Administrativ për procedurat dhe format e shfrytëzimit të energjisë elektrike të lirë dhe të reduktuar.

1.6. Ministria përgjegjëse e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:

1.6.1. udhëzimin Administrativ për përshtatjen e ambientit për lëvizje të mjeteve ortopedike pa pengesa në hyrje të objekteve banesore dhe institucioneve publike;

1.6.2. udhëzimin Administrativ për caktimin e kushteve dhe kritereve për sigurimin e banimit familjar për invalidët dhe veteranët e UÇK-së dhe familjeve të dëshmorëve;

1.7. Ministria përgjegjëse për çështjet e Financave:

1.7.1. udhëzimin Administrativ për procedurat e realizimit të të drejtave në lehtësimet doganore dhe tatimore.

2. Qeveria e Kosovës, sipas nevojës në bashkëpunim me ministrinë e tjera përkatëse, përveç akteve nënligjore të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, mund të nxjerrin edhe akte të tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 21 Gjobat

1. Me gjobë në para prej tremijë (3.000) deri pesëmijë (5.000) Euro për mos zbatimin e dispozitave të këtij ligji, do të gjobiten për kundërvajtje:

1.1. institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji; dhe

1.2. personat e tjerë juridik përgjegjës, të cilët nuk i përmbahen dispozitave të këtij ligji.

2. Me gjobë në para prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni, do të gjobitet personi përgjegjës i institucionit kompetent dhe eprori i këtij organi.

3. Çdo person, i cili me vetëdije, paraqet deklaratë të rreme apo prezanton dokumente të falsifikuara, me qëllim të përfitimit të të drejtave dhe beneficioneve, të përcaktuara sipas këtij ligji, ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi lidhur me paraqitjen e deklaratës së rreme dhe falsifikim të dokumenteve.

Neni 22 Trajtimi i kërkesave në shqyrtim

1. Të gjitha kërkesat e paraqitura në organin përgjegjës të Ministrisë sipas Ligjit Nr. 02/L-02 për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, të cilat janë në shqyrtim e sipër, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të rregullohen dhe përcaktohen sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj janë të pranueshme vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe asnjë person nuk mund të kërkojë realizimin e këtyre të drejtave në mënyrë retroaktive.

Neni 23 **Zbatimi i ligjit**

1. Aktet dhe dispozitat e nxjerra nga organet kompetente të UÇK-së dhe TMK-së janë të vlefshme për zbatimin e këtij ligji, pas verifikimit nga komisioni qeveritar i paraparë në nenin 15 të këtij ligji.
2. Shfrytëzuesit e pensionit bazë, mund të realizojnë të gjitha të drejtat dhe benificionet e përcaktuara me këtë ligj, nëse i përmbushin kushtet dhe kriteret sipas dispozitave të këtij ligji,
3. Shfrytëzuesit e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara, nuk mund të jenë shfrytëzues të të drejtave nga ky ligj.

Neni 24 **Lartësia e shumës së pensioneve**

Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve dhe benficioneve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 25 **Beneficionet Subjekt i Vështirësive Fiskale**

1. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, pagesa e cilitdo dhe të gjitha benficioneve financiare të siguruar nga ky ligj duhet të kërkohet vetëm deri në atë masë që:
 - 1.1. fondet janë përvetësuar veçmas për një qëllim të tillë, sipas ligjit të aplikueshëm për buxhetin vjetor;
 - 1.2. ka fonde të mjaftueshme faktikisht në dispozicion për pagesa të tilla; dhe
 - 1.3. Qeveria nuk ka lëshuar vendim nën paragrafin 2. të këtij neni që redukton apo eliminon pagesa të tilla.
2. Në masën që Qeveria e sheh të domosdoshme për të adresuar rrethanat që krijojnë tendosje të paparapara fiskale në buxhetin publik apo që përndryshe të sigurojë ruajtjen e disiplinës fiskale publike, Qeveria do të ketë autoritetin që të lëshojë një vendim që redukton apo eliminon çfarëdo benficiioni të siguruar me këtë ligj, përfshirë benficionet që kanë të bëjnë me pagesa financiare madje edhe nëse janë përvetësuar fondet sipas ligjit të buxhetit të aplikueshëm në atë kohë.

Neni 26 **Dispozitat Kalimtare**

Ata përfitues që kanë gëzuar benficione para datës 15 maj 2011, do të vazhdojnë t'i gëzojnë ato benficione. Nëse gjatë procesit të auditimit bëhet e ditur se disa nga këto benficione janë përfituar në mënyrë të padrejtë, atëherë këto benficione do të ndërpriten.

Neni 27 **Shfuqizimi i dispozitave ligjore**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen:
 - 1.1. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/66 e datës 21.12.2000 për benficionet për invalidët e luftës dhe të afërmeve të atyre që kanë vdekur, si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë;
 - 1.2. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/29 e datës 2 maj 2006 për shpalljen e Ligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të konfliktit të armatosur në Kosovë;
 - 1.3. Ligji nr. 02/L-02 për statusin dhe të drejtat e familjeve të Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, si dhe,
 - 1.4. çdo dispozitë tjetër e aktit ligjor apo nënligjor e cila është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa do të zbatohet nga 01.01.2012.

Ligji Nr. 04/L-054
8 dhjetor 2011

Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

SHTOJCA E LIGJIT Nr. 04/L-054 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E DËSHMORËVE, INVALIDËVE, VETERANËVE, PJESËTARËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, VIKTIMAVE CIVILE DHE FAMILJEVE TË TYRE

LARTËSIA E PENSIONEVE	
Pensionet familjare për familjet e Dëshmorëve të UÇK-së	
Familja që e ka dhënë një Dëshmor:	358,50 €
Familja që i ka dhënë dy Dëshmorë:	428,70 €
Familja që i ka dhënë tre Dëshmorë:	463,80 €
Familja që i ka dhënë katër Dëshmorë:	498,90 €
Familja që i ka dhënë më shumë se 4 Dëshmorë:	534,00 €
Pensionet familjare për familjet e të zhdukurve të UÇK-së	
Familja me një të zhdukur të UÇK-së	358,50 €
Familja me dy të zhdukur të UÇK-së	428,70 €
Familja me tre të zhdukur të UÇK-së	463,80 €
Familja me katër të zhdukur të UÇK-së	498,90 €
Familja me më shumë se 4 të zhdukur të UÇK-së	534,00 €
Pensionet invalidore personale për Invalidët e UÇK-së	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	358,50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 71- 80%	330,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 70%	315,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 51- 60%	300,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 41 -50%	285,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 31- 40%	255,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 20 -30%	180,00 €
Shtesa për përkujdesje dhe ndihmë për Invalidët e UÇK-së	
Kujdestari për Invalidin me dëmtim trupor me mbi 80%	180,00 €
Pensionet familjare pas vdekjes së invalidit të UÇK-së	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	286,80 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 71- 80%	264,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 70%	252,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 51- 60%	240,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 41 -50%	228,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 31- 40%	204,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 20 -30%	144,00 €
Pensionet familjare për familjet e Viktimave Civile	
Familja e Viktimës Civile	135,00 €
Pensionet familjare për familjet e të Zhdukurve Civil	

Familja e të Zhdukurit Civil	135,00 €
Pensionet invalidore personale për Invalidët Civil të Luftës	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	122,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 80%	109,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 40- 60%	96,00 €
Shtesa për përkujdesje dhe ndihmë për Invalidët Civil të Luftës	
Kujdestari për Invalidin me dëmtim trupor me mbi 80%	40,10 €
E drejta në pensionin familjar pas vdekjes së invalidit Civil të Luftës	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	98,60 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 80%	88,20 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 40- 60%	77,80 €

**LIGJI Nr. 04/L-079
PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2012**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të paragrafëve (1) dhe (5) të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 21 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;

Me qëllim të përcaktimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin fiskal 2012,

Miraton

LIGJ PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2012

**Neni 1
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. Buxheti i Republikës së Kosovës - shuma e lejuar me ligj e cila vihet në dispozicion për shpenzim nga Fondi i Kosovës për një program apo qëllim specifik apo, aty ku nuk është identifikuar qëllimi specifik, për një kategori të shpenzimeve të një Organizate Buxhetore, si është e paraparë në këtë Ligj për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

1.2. Mëditjet - pagesa plotësuese që merret parasysht për:

1.2.1. ngarkimi me detyra specifike me përgjegjësi të veçanta;

1.2.2. detyra të punës të cilat janë të rrezikshme; dhe

1.2.3. puna e natës e cila nuk paguhet si punë jashtë orarit.

1.3. Bilancet - shumat e zotimeve të papritura, ndarjeve buxhetore të pa alokuara, alokimet e pa zotuar dhe çfarëdo të ardhurash të një shume më të madhe se sa shuma e shpenzimeve dhe zotimet e papritura të bartura nga viti fiskal paraprak.

1.4. Organizatat Buxhetore - të gjitha Ministrinë, Komunitat apo Agjencitë të cilat pranojnë ndarje buxhetore nga Fondi i Kosovës sipas këtij Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

1.5. Të hyrat vetanake të Organizatës Buxhetore Qendrore – çfarëdo formë të parasë publike e cila është vlerësuar ligjërisht në bazë të kthimit të kostos dhe e mbledhur si tarifa dhe pagesa nga Organizatat Buxhetore Qendrore. Megjithatë, ky përkufizim në veçanti përjashton të Ardhurat e Dedikuara për Agjencitë e Pavarura.

1.6. Organizatat Buxhetore Qendrore - të gjitha Organizatat Buxhetore duke përjashtuar Komunitat.

1.7. Zotimet - shpenzimet e parashikuara, për të cilat Urdhëresa për Pagesë të Zotimit është plotësuar me rregull në pajtim me Rregullat Financiare të Thesarit dhe të cilat janë regjistruar në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës, pa marrë parasysht nëse i nënshtrohen apo jo ndonjë detyrimi ligjor.

1.8. Të Ardhurat e Dedikuara - paratë publike të cilat janë të përfituara nga burimet e posaçme të të ardhurave dhe kërkohet me ligj që ti ndahen një Agjencie të Pavarur.

1.9. Njësitë e Përcaktuara - ato njësi të përfshira në Listën A të LMFP.

1.10. Pozita e të punësuarit - pozitën me orar të plotë apo ekuivalentin e orarit të plotë të punësimit të paraparë në Tabelën 2 të këtij Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

1.11. **ZRrE** - Zyrën e Rregullatorit për Energji e themeluar në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë.

1.12. **Kategoritë e shpenzimeve** - kategoritë për shpenzime të cilat gjenden në këtë Ligj për Buxhetin e Republikës së Kosovës: Pagat dhe Mëditjet, Mallrat dhe Shërbimet, Shërbimet Komunale, Subvencionet dhe Transferet, Shpenzimet Kapitale dhe Rezervat.

1.13. **Shpenzimet** - pagesat e parave nga Fondi i Kosovës.

1.14. **Viti Fiskal** - periudhën nga 1 janari i një viti deri 31 dhjetor të vitit të njëjtë.

1.15. **Alokimi i fondeve** – shuma maksimale për Shpenzime dhe Zotime që mund të bëhen kundrejt ndarjeve specifike buxhetore, siç është përcaktuar me procedurat e përfshira në nenin 34 të LMFPF dhe të regjistruara në SIMFK.

1.16. **Agjenci e pavarur** – trupat publik, autoritetet apo agjencitë të cilat janë përcaktuar si të pavarura në bazë të Kushtetutës apo në bazë të ligjit dhe që ushtrojnë fuqi rregullatore, ekzekutive, të administrimit publik apo gjyqësore.

1.17. **Fondi i Kosovës** - fondin e krijuar në Bankën Qendrore të Kosovës dhe llogaritë tjera bankare komerciale të cilat mund të krijohen nga Thesari dhe ku të gjitha paratë publike, duke përfshirë edhe interesin e mbledhur nga këto, janë të depozituara dhe nga të cilat bëhen të gjitha Shpenzimet në pajtim me këtë Ligj për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

1.18. **Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK)**- regjistri kontabël i themeluar përbrenda Thesarit të Ministrisë së Financave. SIMFK si përdoret këtu ka kuptimin e njëjtë si termi “Regjistrin Kontabël të Thesarit” i cili është i definuar në LMFPF.

1.19. **AKP** - Agjencia Kosovare e Pronave e themeluar në bazë të Rregullores Nr. 2006/10 të UNMIK-ut të datës 4 mars 2006 dhe të ndryshuar me Rregulloren Nr. 2006/50 të UNMIK-ut të datës 16 tetor 2006 dhe Ligjit Nr. 03/L-079 për ndryshimin e Rregullores të UNMIK-ut Nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur për pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

1.20. **Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës** – ky ligj i miratuar nga Kuvendi për vitin fiskal 2012.

1.21. **LMFPF** – Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

1.22. **Ministër** - Ministri i Financave.

1.23. **Të hyrat vetanake të komunave** - çfarëdo artikulli të parasë publike e cila është vlerësuar dhe mbledhur ligjërisht nga komunat nga burimet e specifikuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.

1.24. **Komunat e reja** - komunat të cilat janë themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ.

1.25. **Detyrim** - marrëveshje ligjore, siç është kontrata apo urdhëresa për blerje, e cila është lidhur nga një Organizatë Buxhetore, që të kryej shpenzimin në të ardhmen.

1.26. **Fondet e pashpërndara** - shumat e parave të cilat kanë mbetur të pandara apo të pashpenzuara në Fondin e Kosovës deri më 31 dhjetor të Vitit paraprak fiskal.

1.27. **RTK** - Radio Televizionin e Kosovës i cili është themeluar në përputhje me Ligjin nr. 02/I-047 për Radio Televizionin e Kosovës.

1.28. **Thesari** - Departamentin e Thesarit përbrenda Ministrisë së Financave.

1.29. **Rregullat Financiare të Thesarit** - Rregullat për Kontrollin dhe Menaxhimin Financiar, siç është e definuar në LMFPF.

1.30. **Fondi i Mirëbesimit** - paratë publike të cilat mbahen nga një organizatë buxhetore për dobi të një personi, organi apo ndërmarrjeje e që nuk është organizatë buxhetore.

2. Çfarëdo termash të përdorura në këtë ligj për Buxhetin e Republikës së Kosovës e të cilat nuk janë definuar këtu do të kenë kuptimin i cili u përshkruhet në LMFP.

Neni 2 **Miratimi i Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2012**

Buxheti i Kosovës për vitin fiskal 2012 siç është i përcaktuar në Tabelën 1, miratohet në bazë të këtij ligji.

Neni 3 **Ndarjet Buxhetore të Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës**

1. Ndarjet Buxhetore nga Fondi i Kosovës për vitin fiskal 2012, siç është i paraqitur në Tabelën 3.1, Tabelën 3.1A dhe Tabelën 4.1 të bashkangjitura këtij ligji, miratohen në bazë të këtij ligji.

2. Ministri do të mbajë regjistrin e të gjitha ndarjeve buxhetore të miratuara, transferet e ndarjeve buxhetore dhe përshtatjet tjera të miratuara të ndarjeve buxhetore të kryera gjatë vitit Fiskal 2012 përmes SIMFK dhe të plotësuar nëse është kërkesa me regjistra tjerë. Të paktën dy herë në vit, gjatë shqyrtimit të raportit gjashtëmuor dhe raportimit përfundimtar për mbylljen e vitit fiskal Ministri mbi bazën e këtij regjistri do të raportoj për ndryshimet dhe përshtatjet buxhetore të ndodhura gjatë vitit fiskal 2012.

3. Në çdo kohë kur kërkohet nga Kuvendi, Ministri, në emër të Qeverisë, prezanton para Kuvendit raportin gjithëpërfshirës që ofron detajet dhe barazimin e ndarjeve buxhetore të aprovuara për vitin 2012, dhe të gjitha transferet pasuese dhe ndryshimet tjera, dhe ndarjet buxhetore finale për vitin fiskal 2012.

Neni 4 **Ndarjet buxhetore komunale**

1. Pavarësisht nga neni 3 i këtij ligji, Ndarjet buxhetore në Tabelën 4.1. që janë të bazuara në Të hyrat vetanake komunale janë të autorizuar vetëm në atë nivel ku të hyrat e tilla depozitohen në Fondin e Kosovës dhe regjistrohen në kohë në SIMFK.

2. Në rastet kur gjatë vitit fiskal shumat e të hyrave vetanake të një komune, që janë depozituar në Fondin e Kosovës dhe regjistruar në SIMFK, kalojnë shumat e të hyrave të ndara në Tabelën 4.1 të asaj komune; Thesari do të regjistroj këto mjete si bilance në dispozicion të komunave përkatëse. Këto bilance janë në dispozicion për të financuar ndarjet shitesë buxhetore në vitin aktual ose vitet vijuese të aprovuara në përputhje me procedurat e përcaktuara në LMFP.

3. Të hyrat vetanake komunale nga arsimi duhet të regjistrohen veçmas. Të hyrat e tilla mund të autorizohen dhe shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime të arsimit.

4. Të hyrat vetanake nga bashkë-pagesat e kujdesit primar shëndetësor duhet të regjistrohen veçmas dhe të hyrat e tilla mund të autorizohen dhe shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime të kujdesit primar shëndetësor.

5. Deri në themelimin e komunës së re, ndarjet buxhetore mund të shpenzohen vetëm nga komunat ekzistuese për qëllime nga të cilat përfitojnë komunitet brenda zonave kadastrale të komunave të reja dhe në konsultim me palët relevante, përfshirë Ministrinë e Pushtetit Lokal, Zyrën e përfaqësuesit civil ndërkombëtar dhe përfaqësuesit e popullatës së zonave kadastrale. Ndarja buxhetore për komunën e re të Mitrovicës veriore në Tabelën 4.1 është përfshirë brenda buxhetit për komunën e Mitrovicës dhe mund të shpenzohet vetëm për çështjet nga të cilat përfitojnë komunitetet brenda zonës kadastrale të Mitrovicës veriore.

6. Pas themelimit të një Komune të Re si një Organizatë Buxhetore në përputhje me Ligjin mbi Kufijtë Administrativ të Komunave, Ligji Nr. 03/L-041, Ministri, në konsultim me Ministrin e Administratës së Pushtetit Lokal dhe Kryetarin e Komunës, transferon ndarje buxhetore të mjaftueshme nga organizata buxhetore ekzistuese tek komuna e re, në përputhje me alokimin e granteve të bërë nga Komisioni i Granteve:

6.1. pas themelimit të një Komune të Re si Organizatë Buxhetore, Ministri mund të nxjerrë udhëzime administrative lidhur me qeverisjen, financimin, administrimin dhe kontrollin intern për këto komuna në konsultim me Ministrin e Administratës së Pushtetit Lokal, Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar dhe komunat përkatëse.

7. Ndarjet buxhetore për Komunën e re mund të ndryshohen nga Kryetari i Komunës me anë të procesit për rishikim të

buxhetit që zhvillohet në përputhje me rregulloret e zbatueshme të përcaktuara në LMFPP dhe brenda limiteve të financimit të përcaktuara për komunën në këtë ligj. Ndryshimet në ndarjet buxhetore pas aprovimit nga Kuvendi Komunal dorëzohen tek Ministri për regjistrim në SMIFK.

Neni 5 **Të hyrat vetanake të Organizatave buxhetore të nivelit qendror**

1. Të gjitha të hyrat vetanake për organizatat buxhetore të nivelit qendror duhet të depozitohen nga Organizatat buxhetore qendrore në Fondin e Kosovës dhe regjistrohen në SIMFK në pajtim me Rregullat financiare të Thesarit. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 3 të këtij ligji dhe ndarjet buxhetore në tabelën 3.1., të hyrat vetanake të nivelit qendror janë të ndara vetëm në atë nivel ku të hyrat e tilla depozitohen në Fondin e Kosovës dhe regjistrohen në kohë në SIMFK.

2. Në rastet kur gjatë vitit fiskal shumat e të hyrave vetanake të një organizate të nivelit qendror që janë depozituar në Fondin e Kosovës dhe regjistruar në SIMFK kalojnë shumat e të hyrave të ndara në Tabelën 3.1. të asaj organizate buxhetore, apo mbesin të pashpenzuara në fund të vitit fiskal, atëherë ato të hyra bëhen të hyra të përgjithshme.

Neni 6 **Të hyrat e dedikuara të Agjencive të pavarura**

1. Të gjitha të hyrat e dedikuara duhet të depozitohen nga Agjencitë e pavarura në Fondin e Kosovës dhe regjistrohen në SIMFK në pajtim me Rregullat financiare të Thesarit. Të gjitha Agjencitë e pavarura duhet të dorëzojnë planin e rrjedhës së parasë së gatshme në Thesar.

2. Të gjitha të hyrat e dedikuara ndahen për secilën Agjenci të pavarur sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. Buxheti i Republikës së Kosovës përfshin të gjitha të hyrat e dedikuara ashtu si pranohen gjatë vitit fiskal 2012.

3. Tërë bilanci i pashpenzuar i të hyrave të dedikuara nga viti fiskal 2011 ndahet dhe autorizohet për vitin fiskal 2012 për Agjencitë e pavarura sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, me kusht që shuma maksimale e të Hyrave të Dedikuara e cila ndahet përmes këtij ligji nuk duhet të tejkalojë shumën e specifikuar në tabelën 3.1 të këtij ligji dhe pjesa e mbetur më nuk mund të konsiderohet si e Hyrë e Dedikuar.

4. Shuma e të hyrave të dedikuara të ndara në paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni nuk duhet të kalojë ndarjen maksimale për agjencitë e pavarura të specifikuar në Tabelën 3.1 të këtij ligji.

5. Nëse gjatë vitit fiskal 2012 nuk ka mjete të mjaftueshme të mbledhura dhe në dispozicion, sipas paragrafëve 2. dhe 3. të këtij neni, për të plotësuar kërkesat e përcaktuara në planin e rrjedhës së parasë së gatshme të dorëzuar në Thesar, fondet tjera publike nga Fondi i Kosovës autorizohen në këtë mënyrë për tu ndarë në një shumë të mjaftueshme për të plotësuar deficitin. Sidoqoftë, gjatë tërë kohës të hyrat e dedikuara duhet të përdoren si burim financimi me prioritet të parë për pagesat e Shpenzimeve të Agjencisë së pavarur para se të ndahen dhe përdoren burimet tjera të financimit. Ministri, së paku dy herë në vit, gjatë rishikimit buxhetor dhe në Raportin Financiar, i raporton Komisionit për Buxhet dhe Financa nëse fondet kanë qenë të mjaftueshme dhe cilat masa janë marrë që fondet e dhura të jenë në dispozicion.

6. Përderisa pranohen dhe ndahen të hyrat e dedikuara për vitin fiskal 2012, ato do të zëvendësojnë të tërë ndarjet dhe financimet e bëra sipas paragrafit 5. të këtij neni në atë nivel që financimi i deficitit nga Fondi i Kosovës të mos jetë shpenzuar ende.

7. Pavarësisht nga paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni, sipas Ligjit për Agjencinë e Privatizimit të Kosovës (AKP), Ligji Nr. 04 / L-034, pesë për qind (5%) të të gjitha fondeve të pranuar nga AKP janë të hyra të dedikuara të AKP-së. Nëse ato fonde të transferuara në Fondin e Konsoliduar të Kosovës tejkalojnë ndarjet buxhetore vjetore të AKP-së nga tabela 3.1A, Ministri mund të lidhë një Memorandum të Mirëkuptimit me AKP-në për të mundësuar ndarjet buxhetore shtesë, me kusht që ndarjet buxhetore shtesë të mos kalojnë nivelin e të hyrave shtesë të dedikuara që i janë caktuar AKP-së dhe të depozituara në Fondin e Konsoliduar të Kosovës. Ministri menjëherë njofton Kuvendin/Komisionin për Buxhet e Financa, për çdo ndarje shtesë buxhetore për AKP-në.

Neni 7 **Ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura**

1. Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas lëshimit të ndarjeve buxhetore të plota për vitin fiskal 2012, Qeveria dorëzon në Kuvend Pasqyrën preliminare ku tregohet përbërja e bilanceve të Thesarit dhe të Fondit të Kosovës nga viti fiskal

2011, që përfshijnë:

- 1.1. bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të Qeverisë qendrore;
- 1.2. bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të Komunave;
- 1.3. bilancet e pashpenzuara të granteve të përcaktuara të donatorëve;
- 1.4. bilancin e fondeve të mirëbesimit që mbahen nga organizatat buxhetore;
- 1.5. fondet që do të mbahen si kursime të ruajtura, dhe
- 1.6. huat e pashpenzuara për entitetet e përcaktuara.

2. Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas lëshimit të ndarjeve buxhetore të plota për vitin fiskal 2012, Qeveria dorëzon në Kuvend për informim Tabelën që tregon ndryshimet e bëra në Tabelat 3.2. dhe 4.2. të bashkëngjitura, që kërkohet nga organizatat buxhetore për të përmbushur obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak që lidhen me projektet kapitale shumëvjeçare. Ndryshimet në Tabelat 3.2. dhe 4.2. kufizohen në sa vijon:

- 2.1. ndarja buxhetore totale për projektet kapitale, të dhënë në Tabelat 3.1. dhe 4.1. për cilëndo organizatë buxhetore apo program, nuk do rritet si rezultat i këtyre ndryshimeve;
- 2.2. cilido projekt i ri i shtuar në Tabelat 3.2. dhe 4.2. duhet të jetë projekt kapital që ka qenë pjesë e Tabelës 3 të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit 2011;
- 2.3. sidoqoftë, me kusht që projektet e reja kapitale mund të shtohen në Tabelat 3.2. dhe 4.2. atëherë kur projekti kapital financohet plotësisht nga bilancet e pashpenzuara të cilat janë paraparë në paragrafin 1 të këtij neni dhe të ndara në vitin fiskal 2012.

3. Bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të organizatave buxhetore qendrore nga viti fiskal 2011, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SMIFK si ndarje buxhetore për një organizatë buxhetore qendrore, përmes kësaj ndahen për vitin fiskal 2012.

4. Bilancet e pashpenzuara të "Të hyrave vetanake të komunave" nga viti fiskal 2011 dhe nga vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SMIFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2012.

5. Bilancet e pashpenzuara të granteve të përcaktuara të donatorëve, të regjistruara në SMIFK, ndahen për vitin fiskal 2012 nëse ka një marrëveshje detyruese ligjore në fuqi.

6. Bilancet e pashpenzuara të fondit të mirëbesimit nga viti fiskal 2011 dhe të regjistruara në SIMFK, ndahen për vitin fiskal 2012.

Neni 8 Ndarja e granteve të donatorëve

1. Në pajtim me LMFP, të gjitha grantet e donatorëve depozitohen në Fondin e Kosovës, përveç nëse kërkohet ndryshe nga donatori dhe nëse ka një pajtim me shkrim nga ana e Ministrit. Të gjitha grantet e donatorëve duhet të regjistrohen në SIMFK.

2. Pas kompletimit të procedurave sipas Rregullave financiare të Thesarit, grantet e donatorëve do të ndahen për qëllim(et) e specifikuar, dhe mund të alokohen dhe të shpenzohen për at(o) qëllim(e).

3. Kur marrëveshja për grantin e donatorit kërkon shprehimisht që donatori të bëjë kompensimin e shpenzimeve të caktuara që shkaktohen nga organizata buxhetore, shuma e plotë e grantit ndahet pas ekzekutimit të marrëveshjes së grantit.

Neni 9 Ndarjet buxhetore të tjera

1. Të gjitha paratë publike që mbahen nga Agjencia Kosovare e Pronave (AKP) në ushtrimin e përgjegjësisë së saj për

përcaktim, implementim dhe administrim të Skemës së qirave për pronat që AKP i ka në inventarin e saj, dhe pagesat tjera përkatëse nga llogaria e AKP-së, regjistrohen si duhet në SIMFK dhe konsiderohen si pjesë e Fondit të Kosovës në përputhje me kornizën legjislative të AKP-së, LMFPP-në dhe rregullat financiare të Thesarit. Ato para publike që mbahen nga AKP-ja, do të konsiderohen të ndara për qëllim(et) specifike, të autorizuar sipas ligjit të zbatueshëm dhe Skemës së qirave të AKP-së, dhe mund të alokohen dhe shpenzohen për at(o) qëllim(e).

2. Të gjitha tarifat e transmetuesit publik, të transferuara në Fondin e Kosovës nga ana e RTK-së, që përbëjnë atë pesë përqind (5%) të tarifave të transmetuesit publik, dhe që janë të përcaktuara për përkrahjen e mediave minoritare, shumë etnike dhe në situatë të pafavorshme, përmes kësaj i ndahen Zyres së Kryeministrit në përputhje me paragrafin 11. të nenit 20 të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës (RTK).

3. Të gjitha fondet e mirëbesimit do të regjistrohen si duhet në SIMFK dhe do të konsiderohen pjesë e Fondit të Kosovës, në përputhje me LMFPP-në dhe me rregullat financiare të Thesarit. Ato fonde të mirëbesimit përmes kësaj ndahen për shfrytëzim nga apo në emër të përfituesve të përcaktuar.

Neni 10 **Limitet në zotime dhe shpenzime**

1. Asnjë organizatë buxhetore nuk mund të tejkalojë numrin e pozitave të punësimit, në asnjë kohë gjatë vitit fiskal 2012, të specifikuar në Tabelat 3.1., 3.1A. dhe 4.1. të bashkëngjitur në këtë ligj.

2. Me kusht që numri i të punësuarve të caktuar për programin në Tabelën 3.1., 3.1A. apo 4.1. mund të përshtatet nga vendimi i qeverisë në rrethanat vijuese:

2.1. numri i pozitave të punësimit i përcaktuar në Tabelën 4.1 për të gjitha komunat e reja të krijuara në vitet 2011 dhe 2012, mund të ndryshohet nga Kryetari i Komunës, me kusht që ai ndryshim të mos kalojë njëzet përqind (20%) të numrit total të pozitave të aprovuara nga Komuna në përputhje me Ligjin. Të gjitha ndryshimet në numrin e stafit duhet të aprovohen nga Kuvendi Komunal. Të gjitha këto ndryshime të aprovuara në lidhje me stafin i dorëzohen Ministrit që do të bëjë azhurnimin e tyre në Tabelën 4.1.

3. Punonjësit e Organizatave Buxhetore të Institucioneve të Pavarura që kanë pagat e tyre jashtë sistemit të pagave të Shërbyesve Civil, nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën për shuajta dhe rritjen prej tridhjetë përqind (30%) sipas vendimit të Qeverisë.

4. Dështimi për të respektuar limitet në numrin e të punësuarve është shkelje e këtij ligji dhe e LMFPP-së.

5. Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve subvencione e transfere, është i kufizuar në rrethanat kur ka bazë ligjore të qartë sipas këtij ligji dhe ndonjë ligji tjetër për ato shpenzime.

6. Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra e shërbime, nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat.

7. Një organizatë buxhetore nuk duhet të shpallë ftesën për tender për një projekt kapital të aprovuar, të identifikuar në Tabelat 3.2 dhe 4.2, pas 31 tetorit 2012, për shpenzim potencial në vitin fiskal 2012, përveç nëse ato shpenzime janë planifikuar për atë projekt kapital për vitet 2012 apo 2013, në Tabelat 3.2. dhe 4.2.

8. Shpenzimet që kanë të bëjnë me shpronësimin duhet të aprovohen nga Qeveria para se të bëhet shpenzimi i tyre.

9. Në rast se një individ, zyrtar, person apo një entitet pranon ndonjë pagesë nga Fondi i Kosovës, si rrjedhim i gabimit, ngatërrimit apo lëshimit, ato fonde i kthehen Fondit të Kosovës në afat prej pesë (5) ditësh nga pranimi i njoftimit me shkrim nga Drejtori i Thesarit, me të cilin njoftohet pala pranuese që ajo pagesë është bërë gabimisht:

9.1. në rastet kur një organizatë buxhetore vëren që është bërë një pagesë e padrejtë, ajo informon menjëherë Drejtorin e Thesarit dhe menjëherë jepet urdhri për kthim;

9.2. në rastet kur është bërë një pagesë e padrejtë dhe nuk është bërë kthimi, Drejtori i Thesarit ka tërë autoritetin për të përdorur mjetet e nevojshme juridike.

Neni 11 **Pagesat e paradhënies**

1. Organizatat Buxhetore mund të paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në maksimumin e pesëmbëdhjetë përqindëshit (15 %) të vlerës së kontratës. Pagesa e tillë e paradhënies mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur ligjore me vlerë më të lartë se dhjetë mijë (10.000) Euro e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. Për pagesën e paradhënies për projektet kapitale kontrata duhet të përmbajë garancionin e performansës dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, e cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë.
2. Në raste të veçanta, Qeveria mund të aprovoj pagesën e paradhënies në vlerë deri në tridhjetë përqind (30%) të vlerës së kontratës për projektet kapitale. Qeveria mund të aprovojë pagesën e paradhënies prej më shumë se tridhjetë përqind (30%) dhe deri në njëqind përqind (100%) të vlerës së kontratës për mallra dhe shërbime vetëm pas rekomandimit nga Komisioni për Buxhet e Financa të Kuvendit.
3. Për nëntor nuk do të ketë pagesa të paradhënies mbi dhjetë përqind (10%) dhe për dhjetor mbi pesë përqind (5%) të vlerës së kontratës dhe vetëm pas aprovimit nga Ministri i Financave.
4. Organizatat Buxhetore mund të bëjnë pagesat e paradhënies për të punësuarit që udhëtojnë jashtë në përputhje me rregullat që aktualisht janë në fuqi për udhëtimet jashtë vendit dhe në përputhje me rregullat financiare të Thesarit. Paradhëniet e tilla do të mbyllen, ndërsa shumat e pashpenzuara do të kthehen në Fondin e Kosovës, në përputhje me Rregullat Financiare të Thesarit.
5. Nëse paradhëniet për para të imta ose për udhëtime të bëra gjatë vitit 2011 nuk mbyllen para 15 janarit 2012 në përputhje me rregullat financiare të Thesarit, shpenzimet e ndërlydhura me këto avance do të regjistrohen kundrejt ndarjeve buxhetore për 2012.

Neni 12 **Shpenzimet e paparashikuara dhe rezervat**

1. Shpenzimet e paparashikuara janë të ndara në kuadër të programit – Shpenzimet e paparashikuara në Tabelën 3.1. Shuma mund të bartet nga rezerva e paparashikuar në përputhje me nenin 29 të LMFPP. Shumat e autorizuara për shpenzimet e paparashikuara mund të shfrytëzohen vetëm për nevojat urgjente dhe të paplanifikuara.
2. Në harmoni me paragrafin 3. të nenit 29 të LMFPP, Qeveria mund të autorizoj ministrin që të aprovoj transferet nga programi – Shpenzimet e paparashikuara në program tjetër në Tabelat 3.1. dhe 4.1. për shumat individuale të kërkuara deri në vlerën prej njëzet mijë (20.000) Euro. Shuma e totalit të këtij autorizimi nga qeveria të dhënë për Ministrin, nuk mund të kalojë njëzetë për qind (20%) të shumës së ndarë vjetore të programit – Shpenzimet e paparashikuara.
3. Fondet e ndara për Kuadro nën Ministrinë e Financave mund të transferohen tek një Organizatë Buxhetore në kategorinë e shpenzimeve për pagat dhe mëditjet nga Ministri në përputhje me planin e aprovuar nga Qeveria i cili i specifikon pozitat e punësimit dhe të shumave të fondit të cilat janë të nevojshme në mënyrë specifike për të tërhequr dhe mbajtur stafin jopolitik me aftësi të larta në pozitat e rëndësishme të veçantë kombëtare në sferat e zhvillimit të politikave. Të gjitha transferet e tilla me këtë janë të aprovuara dhe si të tilla nuk janë subjekt i limitimeve të transfereve të përfshira në nenin 30 të LMFPP apo të nenit 13 të këtij ligji.
4. Fondet për shpenzimet kontingjente janë të ndara për Rezervën Komunale për Komunitetet e Reja nën Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Kjo rezervë komunale mund të shpenzohet në dobi të komuniteteve përbrenda zonave kadastrale të Komunave të Reja nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në konsultim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar dhe Komunitetet përkatëse, apo tu transferohet drejtpërdrejtë Komunave të Reja, pas themelimit të tyre.
5. Fondet e ndara për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Pushtetit Lokal të cilat janë për bashkëfinancimin e projekteve komunale do të shpenzohen ose transferohen tek komunitetet, por në përputhje me memorandumimin e mirëkuptimit të nënshkruar nga Ministria relevante dhe Kryetari i komunës përkatëse.
6. Fondet rezervë të ndara për Ministrinë e Financave për sektorin e energjisë, mund të transferohen Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në përputhje me një vendim të Qeverisë.

Neni 13

Transferi i shumave të ndara buxhetore

1. Ministri mundet, nëse i ofrohen arsytetime të vlefshme nga kryesuesi i organizatës Buxhetore, të autorizoj transferin e një ose më tepër ndarjeve buxhetore në përputhje me nenin 30 të LMFPP.
2. Ministri mund të transferojë ndarjet buxhetore për shërbime të konsulencës që janë pjesë e buxhetit të Ministrisë së Financave tek ministritë tjera, pasi të ketë marrë aprovimin nga Qeveria, pavarësisht limitimeve të tjera sa u përket transfereve buxhetore që janë pjesë e këtij ligji apo LMFPP-së.
3. Kur Organizata Buxhetore ka nën shpenzim në përputhje me planin e rrjedhës së parave të dorëzuar në Thesar, Ministri mundet gjatë tremujorit të fundit të vitit financiar me aprovimin paraprak nga Qeveria, të autorizoj shkurtimin e ndarjes buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike të asaj organizate buxhetore qendrore dhe të transferoj atë ndarje tek një organizatë tjetër buxhetore. Vlera kumulative e të gjitha këtyre transfereve nuk duhet të tejkaloj pesë përqind (5%) të vlerës totale të të gjitha ndarjeve buxhetore.
4. Pavarësisht paragrafit 1. të këtij neni dhe paragrafit 2. të nenit 10 të këtij ligji, asnjë transfer i ndarjeve buxhetore nuk mund të bëhet në kategorinë e pagave dhe mëditjeve nga ndonjë kategori tjetër ekonomike pa aprovim paraprak të Kuvendit.
5. Transferi i ndarjeve buxhetore brenda kategorisë së pagave dhe mëditjeve mund të bëhet në mes të programeve të së njëjtës organizatë buxhetore me aprovim nga Ministri.
6. Aprovimi paraprak nga Kuvendi kërkohet për çdo transfer ndërmjet organizatave buxhetore.
7. Pas aprovimit të çdo transferi, do të bëhet përshtatja e shumave të ndara në Tabelat 3.1 dhe 4.1 nga ana e Ministrisë dhe e tërë kjo do të regjistrohet në SIMFK.

Neni 14

Ndryshimet në shumat e ndara për projektet kapitale përbrenda një Programi

1. Mjetet mund të alokohen vetëm në projektet kapitale të listuara në Tabelën 3.2. Për projektet kapitale të paraqitura në Tabelën 3.2., Ministri mundet, nëse i ofrohen arsytetime të vlefshme nga ana e kryesuesit të Organizatës Buxhetore, të autorizoj lëvizjen e mjeteve të alokuara nga një projekt kapital në tjetrin brenda programit të njëjtë të asaj Organizate Buxhetore, me kusht që shuma e bartur të jetë më e vogël ose e barabartë me pesëmbëdhjetë përqind (15%) të vlerës totale të kategorisë ekonomike kapitale të aprovuar për atë program.
2. Për çdo projekt kapital të paraqitur në Tabelën 3.2., Ministri mundet, nëse i ofrohen arsytetime të vlefshme nga ana e kryesuesit të Organizatës Buxhetore, të dorëzoj kërkesë për aprovim në Qeveri, për lëvizjen e mjeteve të alokuara nga një projekt kapital në tjetrin brenda programit të njëjtë të asaj Organizate Buxhetore në shumën më të lartë se pesëmbëdhjetë përqind (15%) por më pak se njëzetepesë përqind (25%) të vlerës totale të kategorisë ekonomike kapitale të aprovuar për atë program.
3. Për çdo projekt kapital të paraqitur në Tabelën 3.2., Ministri mundet, nëse i ofrohen arsytetime të vlefshme nga ana e kryesuesit të Organizatës Buxhetore, të dorëzoj kërkesë për aprovim në Kuvend, për lëvizjen e mjeteve të alokuara nga një projekt kapital në tjetrin brenda programit të njëjtë të asaj Organizate Buxhetore në vlerën e barabartë ose më të lartë se njëzetepesë përqind (25%) të vlerës totale të kategorisë ekonomike kapitale të aprovuar për atë program.
4. Projektet e reja kapitale mund të shtohen në Tabelat 3.2. dhe 4.2. me kusht që të financohen sipas procedurave të autorizuara në paragrafin 2. të nenit 5, paragrafin 2. të nenit 8 të këtij ligji, dhe paragrafët 1., 2. dhe 3. të këtij neni, dhe nëse bëhen pjesë e Programit të Investimeve Publike në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Ministri.
5. Për qëllimet e paragrafëve 1., 2., 3. dhe 4. të këtij neni, duhet të përgatitet një arsyetim i vlefshëm nga ana e kryesuesit të Organizatës përkatëse Buxhetore i cili do të përmbajë së paku, faktet që kostoja e vlerësuar e projektit kapital është më e lartë se mjetet në dispozicion që përcaktohet në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, apo që një projekt kapital ka nevojë për më pak se sa shuma e specifikuar, sikurse edhe përkrahimin e ndikimit që kërkesa mund ta ketë në Programin e Investimeve Publike.
6. Pavarësisht dispozitave të lartcekura të këtij Neni, ndryshimi i shumave të alokuara në projektet kapitale për bashkëfinancim me Organizatat Buxhetore që janë paraqitur në Tabelën 3.2. mund të autorizohen nga Ministri pas

miratimit nga Qeveria për Nivelin qendror.

7. Projektet e reja kapitale mund të shtohen në Tabelën 3.2. dhe Tabelën 4.2. vetëm në dy raste; së pari në rast se projektet ekzistuese financohen apo pjesërisht financohen nga donatorët, për aq sa financimi për projekt(et) e reja nuk e tejkalon shumën e financimit nga donatori dhe së dyti, në rast se ka fonde të mbetura nga projektet ekzistuese që janë kompletuar, projekt(et) e reja kapitale mund të shtohen vetëm për aq sa ka fonde të mbetura tepriçë. Nëse komuna propozon të shtohet projekti i ri kapital në Tabelën 4.2., atëherë kërkohet aprovimi paraprak nga Kuvendi Komunal. Ndryshimet e tilla do të regjistrohen në SIMFK nga Ministri, në afat prej pesë (5) ditësh nga pranimi i aprovimit prej Kuvendit Komunal. Nëse organizata buxhetore qendrore propozon të shtohet një projekt i ri kapital, atëherë kërkesa duhet të dorëzohet tek Ministri nga kryesuesi i organizatës buxhetore dhe qeveria duhet të aprovojë shtimin e projektit të ri kapital në Tabelën 3.2. Më pas, projekti duhet të regjistrohet në SIMFK.

8. Ndryshimet në shumat e alokuara për projektet ekzistuese apo zëvendësimin e projekteve kapitale të komunave, të prezantuara në Tabelën 4.2. duhet të aprovohen nga Kuvendi Komunal. Ato ndryshime regjistrohen në SIMFK nga Ministri në afat prej pesë (5) ditësh nga pranimi i aprovimit të dhënë nga ana e Kuvendit Komunal.

Neni 15 Ekzekutimi i Buxhetit

1. Të gjithë zyrtarët kryesor financiar do të sigurojnë që të gjitha obligimet janë të regjistruara në SIMFK në përputhshmëri me LMFPP-në dhe Rregullave Financiare të Thesarit.

2. Zyrtari kryesor financiar i çdo Organizate Buxhetore e cila nuk është komunë apo agjenci e pavarur, i dorëzon Ministrin të Financave brenda tre javëve nga mbyllja e secilit tremujor një raport të detajuar për progresin e arritur në zbatimin e të gjitha projekteve kapitale me vlerë më të lartë se dhjetë mijë (10.000) Euro.

3. Zyrtari Kryesor Financiar i secilës komunë i dorëzon Kryetarit të Komunës brenda tre (3) javëve nga mbyllja e secilit tremujor një raport të detajuar për progresin e arritur në zbatimin e të gjitha projekteve kapitale me vlerë më të lartë se dhjetë mijë (10.000) Euro. Një kopje e raportit të tillë duhet ti dorëzohet edhe Ministrin.

Neni 16 Vlerësimet buxhetore për legjislacionin e propozuar

1. Kurdo që propozohet një projektligj i ri ose një projektligj për ndryshim dhe plotësim të një ligji ekzistues, ministria ose organi propozues, paraprakisht duhet të dorëzojnë projektligjin e ri ose projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit së bashku me një Deklaratë mbi Ndikimin Buxhetor dhe Ekonomik ekzistues në Ministrinë e Financave, për të cilën bëhet një vlerësim detal i ndikimit që mund të ketë legjislacioni i propozuar në Buxhetin e Përgjithshëm të Kosovës dhe ekonominë Kosovare.

2. Propozuesi i një projektligji të ri ose projektligji për ndryshim dhe plotësim të një ligji ekzistues, duhet të merr një Deklaratë buxhetore nga Ministria e Financave lidhur me ndikimet buxhetore të projektligjit të ri ose projektligjit për ndryshim dhe plotësim të ligjit ekzistues, para dorëzimit të tij në Qeveri dhe Kuvend, për shqyrtim dhe miratim.

3. Departamenti i buxhetit në bashkëpunim me Departamentin e Politikave Ekonomike, shqyrtojnë Deklaratën mbi Ndikimin Buxhetor dhe Ekonomik të projektligjit të ri ose projektligjit për ndryshim dhe plotësim të ligjit ekzistues të propozuar dhe paraqesin opinionin e tyre të pavarur lidhur me këto çështje para Qeverisë ose Kuvendit, kur propozues është Kuvendi.

4. Çdo iniciativë e re për shpenzime, përfshirë këtu legjislacionin e ri të propozuar, që nuk ka ndarje buxhetore të përfshirë në tabelat e bashkëngjitura, nuk do të marrë ndarjen buxhetore përveç nëse zbatohen shkurtime përkatëse në ndarjet tjera buxhetore në vlerë të njëjtë.

Neni 17 Kredia për entitetet e përcaktuara dhe Ndërmarrjet në Pronësi Publike

Ministri është i autorizuar që Entiteteve të Përcaktuara sipas paragrafit 2. të nenit 50 të LMFPP-së, apo ndërmarrjeve në pronësi publike sipas Ligjit për Ndërmarrjet në Pronësi Publike Nr. 03/L-087, tu japë kredi të kthyeshme dhe në përputhje me Afatet dhe Kushtet e aprovuara nga Qeveria. Shumat e aprovuara për kredi të tilla ndahen në bazë të këtij ligji dhe janë të paraqitura në Tabelën 1. Kredia e kthyeshme ose kredia do të bazohet në marrëveshjen e arritur në mes të Entitetit të përcaktuar apo Ndërmarrjes në Pronësi Publike që i pranojnë huat ose kreditë në njërën anë, dhe Ministrin në anën tjetër, ndërsa që do të përdoren vetëm për qëllimet e shpenzimeve kapitale.

Neni 18

Fondet për ruajtjen e asistencës emergjente për likuiditet

Në pajtim me parashikimet e specifikuar në Tabelën 1, përfshirë edhe financimin nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore), Ministri i Financave bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar me Bankën Qendrore të Kosovës, do të ndajë vlerën prej dyzetegjashhtë milion (46.000.000) Euro nga bilanci bankar i Qeverisë si rezervë për ruajtjen e asistencës emergjente për likuiditet të sistemit financiar. Këto fonde mund të shfrytëzohen vetëm në pajtim me Memorandumin e Mirëkuptimit për Asistencën emergjente për likuiditet të nënshkruar ndërmjet Guvernatorit të Bankës Qendrore, Ministrin të Financave dhe Kryesuesit të Komisionit për Buxhet e Financa.

Neni 19

Reduktimi i fondeve të alokuara në rast nevojë

Në pajtim me nenin 36 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, më qëllim të ruajtjes së nivelit të mjaftueshëm të rezervës buxhetore për të siguruar qëndrueshmërinë buxhetore, shuma prej gjashtëdhjetë milion (60.000.000) Euro, nga ndarjet buxhetore për vitin 2012, do të mbetet e pa alokuar, deri në realizimin e të hyrave të njëhershme nga shpallja e fituesit të PTK-së. Shuma prej gjashtëdhjetë milion (60.000.000) Euro do të identifikohet nga ndarjet buxhetore të prezantuara në këtë buxhet, përjashtuar ndarjet për kategorinë e pagave dhe mëditjeve si dhe ndarjet për projektin e Autostradës - Rruga 7.

Neni 20

Skadimi i Buxhetit të Republikës së Kosovës

Të gjitha ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës dhe alokimi i mjeteve të bëra në vitin fiskal 2012, automatikisht do të skadojnë në mesnatë të 31 dhjetorit 2012.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2012.

Ligji Nr. 04/L-079
20 dhjetor 2011

Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

